



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**  
**“Logjistikë dhe Siguri Detare”**  
**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Dr. Thoma Korini**

**PhD Genta Rexha**

**Mars / 2020**

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë *Master Profesional* në “Logjistikë dhe Siguri Detare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë *Master Profesional* në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është miratuar me: Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 650, Nr. 10577 Prot., datë 11.10.2018, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda institucionit. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare.

Ky program realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Logjistikë dhe Siguri Detare” në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të dytë *Master Profesional* në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2018 – 2019. Gjatë këtij viti janë regjistruar 29 studentë. Në vitin akademik 2019 – 2020 janë regjistruar 31 studentë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Thoma KORINI dhe PhD Genta Rexha, me mbështetjen e koordinatorës së ASCAL, MSc. Renata QATIPI.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin nëntor 2019, me dorëzimin nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me UAMD, në datat 22 dhe 24 Janar 2020, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit të Studimeve Profesionale, Përgjegjësën e Departamentit të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Koordinatorin e programit të studimit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit (në të cilin UAMD pati pasoja). Me datë 4 dhjetor UAMD dërgon nëpërmjet sistemit vendimin e Rektoratit për pezullimin e procesit mësimor për shkak të tërmetit, deri në një vendim të dytë. Kjo solli vonesa në zhvillimin e vizitës në UAMD.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Më datë 27.02.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 4/26 Prot., datë 27.02.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UAMD përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 405/3 Prot., datë 05.03.2020 “Kthim përgjigje shkresës Nr. 4/26 Prot. Datë 27.02.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”.

Në këtë dokument institucioni nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

Kështu Draft Raporti kthehet në Raport Përfundimtar.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “ Logjistikë dhe Siguri Detare” kontribon në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Në qëllimet strategjike të UAMD përcaktohet ndër të tjera [Evidencë 22, fq.48]: “Ofrimi i përgjigjeve integruese ndaj problematikave rajonale, përmes rajonizimit të fushave studimore në të gjithë Universitetin, nëpërmjet veprimtarive njohëse dhe promovuese, krijuese dhe kërkimore, në kuadër të shkëmbimit të dijes, me synim promovimin e vlerave qytetare dhe komunitare”.		
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë ku transporti detar ka një vend të rëndësishëm në rritjen e shkëmbimeve tregtare.		
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “ Logjistikë dhe Siguri Detare” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UAMD për të përgatitur profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane [Evidencë 17, faqe 1].		
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga takimet me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi si dhe me studentë, GVJ konstaton se hapja e këtij programi studimi ka rezultuar si një nevojë për studime të thelluara për sigurinë detare dhe logjistikën në shërbim të sektorëve të lundrimit detar, për menaxhimin dhe sigurinë portuale dhe të mjeteve detare [Evidencë 25, faqe 5; Takimet me studentë e pedagogë] për t’i shërbyer këtij sektori me rëndësi parësore për qytetin e Durrësit e më gjerë.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë	Në planin strategjik të UAMD, në strategjinë për programe studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës, përcaktohet vendosja e bashkëpunimit strategjik për programet akademike me biznesin, organizatat civile dhe profesionale, në mbështetje të

institucionit.	fakultetit si dhe rishikimi i portofolit aktual të programeve nën kuadrin e tregut të punës, misionit dhe vlerave, nevojave të studentëve, nevojave të bizneseve dhe praktikave më të mira [Evidencë 22, fq.48-49].			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në statutin e UAMD përcaktohet se për programet e studimit në këtë institucion hapja, mbyllja dhe riorganizimi i tyre bazohet në vlerësimin e nevojave duke ndjekur dinamikën e zhvillimit të tregut të punës [Evidencë 17, neni 59]. Gjithashtu në prioritetet strategjike përcaktohet një agazhimin pozitiv me këshillat lokalë dhe organizma të tjerë vendimmarrës, për një gamë të gjerë tematikash, duke përfshirë planifikimin dhe hartimin e strategjive zhvillimore, me shtrirje dhe ndikim në komunitet [Evidencë 22, fq.49].			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Siç përcaktohet në rregullore, Programi i studimeve Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është program studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale një vit akademik, i cili merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në fushat e logjistikës detare dhe të sigurisë portuale e të mjeteve detare, si dhe në veprimtaritë e transportit detar [Evidencë 25, faqe 4].			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Referuar Rregullores së Programit të studimeve, misioni i këtij programi është t’u ofrojë studentëve mundësinë që të thellojnë dhe zhvillojnë dijet si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e navigimit, të logjistikës dhe të sigurisë së mjeteve detare [Evidencë 25, faqe 5]. Duke ju referuar Doktrinës së Forcës Detare të RSH [Evidencë 14], Raportit të Tregut të Punës në Shqipëri [Evidencë 26], kërkesave të tregut të punës për këtë drejtim specifik si dhe diskutimeve me pedagogë të angazhuar në këtë program [Takimet me pedagogë të LSD], GVJ është i mendimit se ky program studimi është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të	Referuar Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” si dhe takimeve me Përgjegjësën e Departamentit dhe Koordinatorin e programit të studimit [Takime në institucion], GVJ konstaton se janë përcaktuar qartë objektivat e formimit të cilat konsistojnë në sa vijon [Evidencë 25, faqe 5]:  a) Përgatitja e specialistëve të logjistikës dhe të sigurisë së transportit dhe mjeteve detare, për të analizuar e vlerësuar situata të ndryshme të menaxhimit e të logjistikës, si dhe të sigurisë në sektorin publik e privat që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e

<p>cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>detarisë në përgjithësi.</p> <p>b) Përgatitja e specialistëve për vlerësimin e problematikave të sigurisë navigacionale dhe kërcënimeve të tjera që janë prezent në fushën e detarisë si dhe hartimi i strategjive përkatëse në përballjen me kërcënime të tilla.</p> <p>c) Përgatitja e specialistëve dhe analistëve të aftë në fushën e ofrimit të ekspertizës në vlerësimin e indikatorëve teknike e menaxheriale në funksion të rritjes së sigurisë navigacionale dhe cilësisë së menaxhimit detar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstaton se nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës, por hapja e programit të studimit është kryer duke reflektuar mbi kërkesat nga punëdhënësit si dhe nga të punësuar në sektorë të ndryshëm të detarisë. <u>[Takime me pedagogë dhe autoritetet drejtuese]</u>.</p> <p>Gjithashtu, nga takimet me studentë të këtij programi studimi <u>[Takime në institucion]</u>, GVJ konstatoi se shumica e tyre janë të punësuar në fusha në të cilat janë të nevojshme njohuritë e përfuara nga ky program studimi. Gjithashtu të dhënat e punësimit për studentët të cilët kanë përfunduar studimet në vitin akademik 2018-2019 tregojnë se shumica e tyre janë të punësuar në drejtime të lidhur ngushtë me formimin e përfuor nga ky program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfllimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar syllabuseve të lëndëve <u>[Evidencë 56]</u>, takimeve me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi, takimeve me studentë <u>[Takime në institucion]</u> si dhe statistikave të punësimit, GVJ është i mendimit se objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfllimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që, në një masë të konsiderueshme, i përgjigjen nevojave të tregut të punës. <i>Megjithatë, GVJ është i mendimit se ka nevojë për një ekuilibrim të elementëve përbërës të syllabuseve si dhe për një mbështetje më të mirë laboratorike.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është hartuar duke u bazuar në programe studimi të ngjajshme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, por duke e përshtatur për një kohëzgjatje njëvjeçare <u>[RVB, Takime në institucion]</u>. Për këtë kanë kontribuar edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione europiane <u>[Evidencë 32, Evidencë 33]</u>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” i cili realizohet në Departamentin e Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcaktuar si program studimi i ciklit të dytë dhe vlerësuar me kredite sipas sistemit europian të vlerësimit me kredite <u>[RVB, Takime në institucion]</u>. Paisja e të diplomuarve me suplementin e diplomës <u>[Evidenca 28]</u> lehtëson lexueshmërinë e diplomës dhe i</p>

vendeve evropiane.	hap rrugë mundësisë për të studime më të avancuara apo të specializuara në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” përfshin kryerjen e praktikës profesionale si një element mjaft i rëndësishëm i formimit. Suksesi i realizimit të saj bazohet në një numër marrëveshjesh të lidhura me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e detarisë [Evidenca 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52].			
<b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” zhvillohet në gjuhën shqipe. Në kuadrin e shkëmbimeve me institucione të arsimit të lartë apo specialistë të huaj të fushës, janë zhvilluar leksione të hapur në gjuhë të huaj [Evidencë 80].			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Ky program studimi është në fillimet e tij (aktualisht viti i dytë), dhe si nga takimi me autoritetet drejtuese ashtu edhe me pedagogët e angazhuar [Takime në institucion], GVJ konstaton se ka një angazhim për të garantuar vazhdimësinë e këtij programi, duke gjykuar se aktualisht dhe për perspektivën e afërt tregu i punës ka dhe do të ketë kërkesa në këtë fushë. Nga ana tjetër, ky program studimi shërben edhe për thellimin e studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi L.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Sipas RVB, në programin e studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” për vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar 9 mësimdhënës, nga të cilët 2 (dy) me titullin Prof. Dr., 1 (një) me titullin Profesor i Asociuar, 4 (katër) me gradën Doktor dhe 2 (dy) personel akademik me M.Sc. Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 10 mësimdhënës [Evidencë shtesë 2].
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton se Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë DSID, përgjegjëse për këtë program [Evidencë 93, Evidencë 94].



<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>CV [Evidenca 39] dhe lista e botimeve [Evidenca 38] të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dëshmojnë për një përputhje të fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të DSID, përgjegjës për programin e studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare”.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Sipas RVB dhe takimeve me autoritetet drejtuese në UAMD (fakultet, department) [Takime në institucion], programi i ciklit të dytë “Master Profesional” në “Logjistikë dhe Siguri Detare” ka një profil që mbulohet tërësisht brenda institucionit. Për çështje specifike angazhohet në një masë të kufizuar personel akademik me kontratë [Evidencë 60].</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="638 801 790 869">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="790 801 1005 869">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1005 801 1220 869">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 801 1444 869">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="638 869 790 907"></td> <td data-bbox="790 869 1005 907"></td> <td data-bbox="1005 869 1220 907"></td> <td data-bbox="1220 869 1444 907" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Administrimi i programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” realizohet nga DSID, mbështetur në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 25], rregulloren e FSP [Evidencë 23], rregulloren e DSID [Evidencë 24] si dhe gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik nga fakultete të tjera të UAMD si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësive respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit UAMD ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase si Universiteti “Ismail Qemali”, Fakulteti i Shkencave Teknike Vlorë, Universiteti Politeknik i Tiranës, Kolegji Profesional i Tiranës, Kolegji Universitar “Luarasi” si dhe institucione të huaja të arsimit të lartë si Latvian Maritime Academy, Riga, Letoni; University of the Aegean, Chios, Greece [Evidencë 68].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>UAMD ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi edhe me komunitetin e biznesit e tregun e punës si: Autoritetin Portual Durrës, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Shoqërinë Adria Ferries S.p.A, Hekurudhën Shqiptare S.A., Kompaninë Shega-Trans sh.a, Autostar Albania sh.a. si dhe Diamant Logistics sh.a. [Evidencë 68].</p>

praktikave të punës apo stazhit etj.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	UAMD ka marrëdhënie zyrtare me komunitetin e biznesit e tregun e punës për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale [Evidencë 68]. Zhvillimi i praktikës kryhet duke ju referuar rregullores përkatëse dhe përfundon me një raport të praktikës profesionale [Evidencë 101].								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UAMD nuk ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit [RVB, Takime në institucion].								
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion rezultojnë se, deri në këtë stad, DSID nuk ka hartuar raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, por pohohet se për arsye të një marrëdhënie të ngushtë me punëdhënësit, zhvillimi i praktikave për vitin e parë ka qenë i suksesshëm [Takime në institucion].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet plotësisht</th> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyllet plotësisht	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht				X
Përmbyllet plotësisht	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet plotësisht</th> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyllet plotësisht	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht				X
Përmbyllet plotësisht	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht						
			X						

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit i ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë i UAMD, është Master 1 vjeçar i organizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me 60 kredite (ECTS) [Evidencë 55].
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, në përputhje me nevojat e territorit, ofron një formim të specializuar në drejtim të logjistikës dhe sigurisë detare.  <i>Masteri Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare” u ofron studentëve mundësinë të thellojnë dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e navigacionit e të menaxhimit detar, të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose	


punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	ndryshme. Njëkohësisht në përfundim të këtij masteri studenti pajiset me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe menaxheriale në fushën e transportit detar. Kompetencat e përfituara do t'i mundësojnë studenteve të jenë të aftë të përballojnë sfidat që karakterizojnë fushën e navigimit, të logjistikës dhe të sigurisë detare [Evidencë 28].			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi është organizuar në mënyrë që të ndërthurë njohuritë teorike në auditor me ato praktike, të mundësuar nga bashkëpunimet me institucione të konsoliduara vendase dhe të huaja në këtë fushë [Evidencë 68], duke krijuar një profil të specialistit, të aftë për t'iu përshtatur nevojave konkrete të tregut të punës në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare.			
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së aplikimit [Evidencë 55], takimeve me GVB dhe koordinatoren e programit të studimit, <i>nisur nga profili i veçantë inxhinierik që programi i studimit mbulon, GVJ rekomandon:</i>			
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Një rishpërndarje më të ekuilibruar të krediteve midis semestrit të parë dhe të dytë. Aktualisht janë 22 ECTS në Sem. I (15 orë/javë në auditor për studentin) dhe 38 ECTS në Sem. II (25 orë/javë në auditor për studentin),</i></li> </ol>			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. <i>Në kurrikulën e programit të konsiderohen orët e praktikave (1 ECTS = 20 – 25 orë në auditor) dhe orët e dedikuara diplomës (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor) si orë në auditor për studentin,</i></li> <li>3. <i>Ndarja e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”,</i></li> <li>4. <i>Evidentimin në kurrikul (jo vetëm në syllabuset e lëndëve) i krediteve të dedikuara detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 - 2 orë në auditor),</i></li> <li>5. <i>Përsa i përket praktikave mësimore, këto të organizohen të grumbulluara në fund të semestrit të dytë, në mënyrë që të mos ndërhyhet në zhvillimin korrekt të veprimtarive të tjera [Evidencë 45, Neni 6, pika f].</i></li> </ol>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkësat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë	Programi i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



<p>përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>detare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), pranë Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP) – UAMD. FSP ka në përbërje të tij 3 Departamente [Evidencë 58]:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë,</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore,</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Institucioni, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Statutin e Universitetit – UAMD, urdhër MASR Nr. 385, datë 09/07/2018 [Evidencë 17],</li> <li>2. Rregulloren e Universitetit, VSA Nr. 154 datë 26.11.2018 [Evidencë 18],</li> <li>3. Rregulloren e Njesisë Kryesore – FSP, VSA Nr. 35 datë 20.05.2019 [Evidencë 23],</li> <li>4. Rregulloren e Njesisë Bazë - DSID, VSA Nr. 69, datë 04/11/2019 [Evidencë e vënë në dispozicion gjatë vizitës në Institucion].</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Mbi bazën e tyre është ngritur Struktura Akademike e FSP si më poshtë:</p> <p>Strukturat drejtuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dekan (Drejtues i Njesisë Kryesore),</li> <li>- 2 zëvendës dekanë,</li> <li>- 3 përgjegjës Departamenti (drejtues të Njësive Bazë),</li> </ul> <p>Strukturat mbështetëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 asistente e drejtuesit të Njesisë Kryesore – FSP,</li> <li>- 1 kryesekretare,</li> <li>- 6 sekretare mësimore,</li> <li>- 4 laborantë.</li> </ul>
	<p>Personeli akademik i angazhuar pranë DSID përbëhet nga 14 PAE (4 me tituj/grada), 26 PAK (3 me tituj/grada) dhe 1 PA. Gjithsej 41 personel akademik i angazhuar pranë këtij Departamenti [Evidencë 59]. Në programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, gjatë vitit akademik 2018 – 2019, janë angazhur 7 PAE (6 me tituj/grada), 2 PAK (1 me tituj/grada), gjithsej 9 staf akademik [Evidencë 60]. Gjatë vitit akademik 2019 – 2020, janë angazhuar 7 PAE (6 me tituj/grada), 3 PAK (1 me tituj/grada), gjithsej 10 staf akademik</p> <p>[Ngarkesa e LSD 2019-2020 ASCAL.pdf].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore,</p>	<p>Në kuadër të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, falë bashkëpunimeve me institucione publike dhe private [Evidencë 68], të cilat zhvillojnë aktivitetin në fushën e</p>

laboratorike e klinike.	logjistikës dhe sigurisë detare, DSID mundëson caktimin nga ana e tyre të një personi përgjegjës për praktikën profesionale, i cili orienton dhe mbështet studentët për zhvillimin korrekt të saj, në përputhje me Udhëzuesin e praktikës [Evidencë 45].			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinatori për programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” është me gradën, Dr. [Evidencë 62]. Në raportet vjetore të Departamentit, ai raporton, krahas programeve të tjera të ofruara nga DSID, edhe për mbarëvajtjen e këtij programi studimi [Evidencë 78].			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.3

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), pranë Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP) – UAMD. DSID disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me statutin dhe rregulloren e Universitetit, rregulloren e fakultetit dhe të departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” është i organizuar në [Evidencë 55]: - 1 lëndë bazë (Kategoria A – 6 ECTS – 10%), - 4 lëndë karakterizuese (Kategoria B – 22 ECTS – 36.67%), - 3 lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese dhe grup-lëndë me zgjedhje (njëra me zgjedhje midis 2 mundësive – Kategoria C – 14 ECTS – 23.33%), - 1 lëndë plotësuese (Praktika profesionale - Kategoria D – 6 ECTS – 10%) - 1 detyrimë përmbyllëse (Mbrojtja e diplomës - Kategoria E – 12 ECTS – 20%). Gjithsej 10 aktivitete formuese.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Secili aktivitet është vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të

	Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është 1 vjeçar, i organizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me 60 kredite (ECTS). Viti akademik i programit të studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” përmban dy semestra të rregullt mësimor me kohëzgjatje 15 - 16 javë mësimore [Evidencë 25, Neni 39].																																
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planin mësimor [Evidencë 55] të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 56] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 25, Neni 42], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Evidencë 56], [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës vlerësohet automatikisht me notën 4 dhe duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm.</i></li> <li>• <i>Të njëjtës masë ndëshkimore do t'i nënshtrohen edhe studentët që kopjojnë në provim ose që kryejnë plagjaturë duke përvetësuar punën akademike të kolegëve ose të autorëve të ndryshëm të disiplinës në fjalë.</i></li> <li>• <i>Korrupsioni aktiv dhe pasiv është i ndaluar dhe ndaj tyre merren masa ekstreme.</i></li> </ul> <p>Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijës [Evidencë 56], [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>provimi i parë (400 pikë të mundshme),</i></li> <li>• <i>detyrat e kursit (100 pikë të mundshme),</i></li> <li>• <i>provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme).</i></li> </ul> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="614 1406 1409 1843"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th> <th>Sistemi i vlerësimit (Nota)</th> <th>Përqindja</th> <th>Pikët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>A</b> (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)</td> <td>10</td> <td>94-100%</td> <td>935-1000</td> </tr> <tr> <td><b>B</b> (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>9</td> <td>85-93%</td> <td>845-934</td> </tr> <tr> <td><b>C+</b> (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)</td> <td>8</td> <td>76-84%</td> <td>755-844</td> </tr> <tr> <td><b>C</b> (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>7</td> <td>67-75%</td> <td>665-754</td> </tr> <tr> <td><b>D</b> (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)</td> <td>6</td> <td>58-66%</td> <td>575-664</td> </tr> <tr> <td><b>E</b> (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kriterëve minimale)</td> <td>5</td> <td>51-57%</td> <td>505-574</td> </tr> <tr> <td><b>FX</b> (Ngel-kërkohe me shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)</td> <td>4</td> <td>≤50%</td> <td>0-504</td> </tr> </tbody> </table>	Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët	<b>A</b> (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000	<b>B</b> (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934	<b>C+</b> (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844	<b>C</b> (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754	<b>D</b> (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664	<b>E</b> (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kriterëve minimale)	5	51-57%	505-574	<b>FX</b> (Ngel-kërkohe me shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504
Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët																														
<b>A</b> (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000																														
<b>B</b> (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934																														
<b>C+</b> (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844																														
<b>C</b> (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754																														
<b>D</b> (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664																														
<b>E</b> (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kriterëve minimale)	5	51-57%	505-574																														
<b>FX</b> (Ngel-kërkohe me shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504																														
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve [Evidencë 25, Neni 27 – 31, 33, Evidencë 63], [cit]:</p> <p>1. <i>Pranimi në programin e ciklit të dytë të studimit Master</i></p>																																

<p>dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p><i>Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimit të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të DSID si një nga njësitë bazë të UAMD-së ku ata aplikojnë.</i></p> <p>2. <i>Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit “Master Profesional” në “Logjistikë dhe Siguri Detare” si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara nga DSID miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatën Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranimë.</i></p> <p>Në dosjen për hapjen e programit të studimit drejtuar MASR [Evidencë 28] përcaktohen kriteret specifike të pranimit, mbi bazën e të cilave studenti pranohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë për të ndjekur programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”:</p> <p><b>Diplomë të sistemit të vjetër/ Diplomë Bachelor në:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Degët e Fakultetit të Shkencave Navale,</i></li> <li>• <i>Degët e Fakultetit të Inxhinierisë,</i></li> <li>• <i>Degët e Fakultetit të Ekonomisë,</i></li> <li>• <i>Degët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore,</i></li> <li>• <i>Degët e Fakultetit të Edukimit.</i></li> </ul> <p>Programet e studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave Navale dhe Fakultetin e Inxhinierisë krijojnë një profil të të diplomuarit, i cili është i përshtatshëm për ndjekjen e ciklit të dytë të studimeve <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”. <b><i>Studentët, të cilët vinë nga Fakultetet e tjera mund të kenë nevojë për mentorim apo tutoriat të dedikuara, për të ndjekur në mënyrë korrekte procesin mësimor të këtij masteri.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidencë 56], bazuar në planin mësimor të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se elementët e përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 janë reflektuar në syllabuset e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e</p>	<p>Në programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, duke qenë viti i parë i implementimit të tij, nuk është paraqitur nevoja e rishikimit të përmbajtjes së programit të studimit. Gjatë takimeve me GVB dhe përgjegjësen e Departamentit u shprehën se, në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimeve, kryesisht të diktuar nga tregu i punës, ka angazhim të plotë për ndjekjen e procedurave</p>

plotë.	përkatëse për reflektimin e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe siguri detare” është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së aplikimit [Evidencë 55], takimeve me GVB dhe koordinatoren e programit të studimit, <i>nisur nga profili i veçantë inxhinierik që programi i studimit mbulon, GVJ rekomandon:</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>Një rishpërndarje më të ekuilibruar të krediteve midis semestrit të parë dhe të dytë. Aktualisht janë 22 ECTS në Sem. I (15 orë/javë në auditor për studentin) dhe 38 ECTS në Sem. II (25 orë/javë në auditor për studentin),</i></li> </ol>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>Në kurrikulën e programit të konsiderohen orët e praktikave (1 ECTS = 20 – 25 orë në auditor) dhe orët e dedikuara diplomës (1 ECTS = 1-2 orë në auditor) si orë në auditor për studentin,</i></li> </ol>
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>Ndarja e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”,</i></li> </ol>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>Evidentimin në kurrikul (jo vetëm në syllabuset e lëndëve) i krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor),</i></li> <li><i>Përsa i përket praktikave mësimore, këto të organizohen të grumbulluara në fund të semestrit të dytë, në mënyrë që të mos ndërhyhet në zhvillimin korrekt të veprimtarive të tjera [Evidencë 45, Neni 6, pika fj].</i></li> </ol>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Në programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, duke qenë viti i parë i implementimit të tij, nuk është paraqitur nevoja e rishikimit të përmbajtjes së syllabuseve. Materialet mësimore janë përgatitur nga pedagogët e lëndëve në formën e dispensave, bazuar në literaturën më të fundit në gjuhë të huaj në fushat përkatëse.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara	Programin i studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” është bazuar në modele programesh studimi ndërkombëtare



për programet e studimit të ciklit të dytë.	[Evidencë 65 – 66 - 67], në bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme publike dhe private në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare [Evidencë 68], duke garantuar përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje të kërkesat e tregut të punës.		
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.			
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Në programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, gjatë vitit akademik 2018 – 2019 [Evidencë 60], janë angazhur 7 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr., 4 Dr., 1 MSc. (kapiten), 2 PAK (1 Prof. Dr. dhe 1 MSc.).  Gjatë vitit akademik 2019–2020 [Ngarkesa LSD 2019-2020 ASCAL.pdf], janë angazhuar 7 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr., 4 Dr., 1 MSc. (kapiten), 3 PAK (1 Prof. Dr. dhe 2 MSc).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Ngarkesa mësimore e mbuluar nga stafi akademik me kohë të plotë, për vitin akademik 2018 – 2019, është 77% dhe për vitin akademik 2019 – 2020, 70%.  Ata përmbushin kërkesat ligjore në fuqi për këtë program studimi dhe për ciklin e dytë, të cilit ai i përket. Niveli i kualifikimit dhe fusha kërkimore – shkencore e personelit akademik të angazhuar, është në përputhje me specifikat e këtij programi studimi, dhe lëndëve të zhvilluara nga ta.
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	Në kuadër të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare”, falë bashkëpunimeve me institucione publike dhe private [Evidencë 68], të cilat zhvillojnë aktivitetin në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare, DSID mundëson caktimin nga ana e tyre të një personi përgjegjës për praktikën profesionale, i cili orienton dhe mbështet studentët për zhvillimin korrekt të saj në përputhje me Udhëzuesin e praktikës [Evidencë 45].  Mbrojtja e diplomës në brezin e parë të studentëve të diplomuar është

natyrës së programit të studimit.	realizuar me “Provim formimi”. <i>GVJ, për vitet në vazhdim të zhvillimit të programit të studimeve, rekomandon diplomimin me “Temë diplome”.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në këtë program studimi nuk janë parashikuar orë laboratorike [Evidencë 55]. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së aplikimit, takimeve me GVB dhe koordinatoren e programit të studimit, <i>nisur nga profili i veçantë inxhinierik që programi i studimit mbulon, GVJ rekomandon ndarjen e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	DSID ka një bashkëpunim të mirë me institucione publike dhe private [Evidencë 68], të cilat zhvillojnë aktivitetin në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare. Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në kuadër të hartimit të programit të studimit, duke sjell një kurrikul, e cila i plotëson nevojat e tregut nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e zbatimit të tij. Nga takimet e zhvilluara nga GVJ u konstatua, që ky bashkëpunim është i vazhdueshëm nga ana e institucionit dhe do të mundësojë ruajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe lidhjen e ngushtë të tij me tregun e punës.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimi i GVJ i zhvilluar me studentët u konstatua një përfshirje dhe interes i tyre në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, duke qenë se shumë prej tyre ishin të punësuar, ose ishin punësuar pas zhvillimit të praktikave mësimore nga Institucione, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në kuadër të logjistikës dhe sigurisë detare.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe siguri detare”, është hartuar në përputhje me nevojat e territorit, e mundësuar nga bashkëpunimet e ngushta me institucione të konsoliduara vendase dhe të huaja në këtë fushë [Evidencë 68]. Ky bashkëpunim është i vazhdueshëm nga ana e institucionit dhe do të mundësojë ruajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe lidhjen e

zhvillimi.	ngushtë të tij me tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ nuk ka patur akses në një udhëzues specifik në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Megjithatë, në një sërë dokumentash si “Statuti i UAMD” [Evidencë 17], “Plani i zhvillimit strategjik 2016-2020” [Evidencë 22], “Formulari i vlerësimit të performances së personelit akademik” [Evidencë 92], “Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë” [Evidencë 73] etj. paraqiten prioritete të tilla si: Inovacioni dhe kreativiteti i burimeve tona njerëzore; rritja e mbështetjes për ekselencë në mësimdhënie etj.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse (FSP, DSID, NjSBC) zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mekanizma të tillë si me “Formularin e vlerësimit të performances së personelit akademik” [Evidencë 92], procedura të asistimit të personelit të ri akademik nga ai më me eksperiencë, ndjekje të orëve të mësimin nga drejtues të DSID etj. [Takime në institucion].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Personeli akademik vlerësohet nga studentët në çdo semestër mbi bazën e një pyetsori [Evidencë 120].
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e pyetsorëve i transmetohen DSID i cili bën dhe analizën përkatëse [Evidencë 76]. Në bashkëpunim me NjSBC bëhet adresimi i problematikës së dalë nga analiza e pyetsorëve. GVJ u njoh gjatë vizitës në institucion me raste të problematikës së dalë dhe zgjidhjeve të dhëna nga instancat përkatëse [Takime në

	institucion].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	DSID merr në analizë gjithë problematikën që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor [Evidencë 78]. Informacioni i përfuar nga pyetsori i studentëve, formulari i vetvlerësimit të personelit akademik, kontrolleve të ushtruara etj. janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies [Takime në institucion].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Nga analiza e dosjes së programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” [Evidencë 28] si dhe nga takimet me Drejtuesen e DSID, personelin akademik dhe studentët [Takime në institucion] rezultojnë se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive për këtë program studimi janë leksionet, seminarët detyrat e kursit, praktika profesionale si dhe orët e hapura.

Ngarkesa totale në auditor [Evidencë 64] është e organizuar në leksione (300 orë), seminare (150 orë), praktikë profesionale (50 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (100 orë), gjithsej 600 orë.

Megjithatë në takime u deklarua se UAMD ndjek modelin amerikan për zhvillimin e orëve: të pa ndara në elementët e mësipërm. Pedagogët e bëjnë ndarjen në funksion të temave të trajtuara.

**Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.


Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është propozuar për t’ju përgjigjur nevojës për specialistë në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare mbi bazën e kërkesave të punëdhënësve dhe si një thellim i ciklit Bachelor të propozuar nga FSP. Format e mësimdhënies gërshtojnë formimin klasik nëpërmjet veprimtarive në auditor me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 53] e cila synon të vendosë studentët në situatë reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional. Komponenti i cili mbetet për t’u zhvilluar dhe që tashmë përbën një prioritet të DSID është ai i punëve laboratorike duke mundësuar përdorimin e softuerëve të cilët do të kontribuonin në zhvillimin e kapaciteteve të simulimit të proceseve [Takime në institucion].

**Kriteri 3.** Institucioni mbështet

NjsBC dhe në mënyrë të veçantë DSID mbështet personelin e tij

<p>personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të DSID [Takime në institucion]. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) [Evidencë 80] i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi si dhe me studentët, GVJ konstaton se ka një angazhim të personelit akademik për të përshtatur format e mësimdhënies me natyrën e lëndës së zhvilluar [Takim me stafin akademik]. Në mënyrë të veçantë synohet dhënia e detyrave të kursit për zhvillimin e tyre në grup dhe referimin nëpërmjet prezantimeve ppt para kursit të studentëve [Takim me studentët].</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i metodave të mësimdhënies kryhet nëpërmjet [RVB, Takime në institucion]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- informacionit të përfutur nga pyetsori i studentëve;</li> <li>- formularit të vetvlerësimit të personelit akademik;</li> <li>- kontrolleve të ushtruara;</li> <li>- vlerësimit nga kolegët;</li> <li>- tutoratit të profesoratit të ri; etj.</li> </ul> <p>Rezultatet e vlerësimit dhe propozimet për përmirësim trajtohen nëpërmjet analizave të aktivitetit të DSID [Evidencë 78].</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimet me studentët [Takime në institucion], GVJ konstaton se ka një bashkëveprim të studentëve gjatë seancave mësimore duke marrë pjesë në diskutim për çështjet e trajtuara. Gjithashtu, nga ana e personelit akademik synohet inkurajimi i punës në grup.</p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nëpërmjet rritjes së peshës së detyrave të kursit synohet stimulimi i punës së pavarur të studentëve. Megjithatë, përgatitja e detyrave të kursit monitorohet e mbështetet nga personeli akademik gjatë gjithë kohës së realizimit, duke u përmblytur me një referim përpara studentëve të kursit [Takime në institucion]. Ky i fundit shoqërohet edhe me diskutime në grup me synimin përmirësimin e shprehive të komunikimit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre [Takime me pedagogët, studentët]. Sipas RVB, një tjetër aspekt është dhe përfshirja e studentëve në konferencat studentore të organizuara nga FSP.</p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.3**  
**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional,**



**duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi mësimor për programin e studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” zhvillohet në fundjavë (e shtunë dhe e diel). Kjo bën të mundur që të kenë në dispozicion hapësira të mjaftueshme dhe cilësore dhe të respektohet kërkesa për hapësirën e nevojshme për student [RVB, Vizita në ambientet e zhvillimit të mësimit].
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Zhvillimit të mësimit për këtë program studimi i është dedikuar Kabineti i Navigacionit, i cili plotëson kushtet për zhvillimin cilësor të procesit mësimor (i pajisur me logjistikën e nevojshme projektor, stenda etj.) [Vizita në ambientet e zhvillimit të mësimit]. Përsa u përket praktikave, ato zhvillohen në institucionet me të cilat UAMD ka marrëveshje [Evidencë 68].
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Nga takimet me studentët dhe personelin akademik, GVJ, në fazën aktuale, nuk konstatoi ndonjë mangësi përsa i përket sistemeve informatike, infrastrukturës së përgjithshme IT të nevojshme për studentët [Takime me pedagogët, studentët]. Megjithatë, referuar pyetsorëve të studentëve [Evidencë 74], vërehet se në raport me TIK, rrjetin e internetit, mjaftueshmërinë e paisjeve etj., ka probleme që janë konstatuar dhe janë adresuar nga instancat përkatëse [Takim me NjsBC].
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ konstatoi se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në trajtën e leksioneve të përgatitur nga pedagogët përkatës. Kopjet fizike të leksioneve të lëndëve të këtij programi studimi janë të depozituara në DSID dhe në Bibliotekën e UAMD [Vizita në DSID, Bibliotekë].
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimit kryesor të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e UAMD disponon një numër botimesh për drejtimet kryesore të programit si dhe hapsirat e mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët [Vizita në bibliotekë]. Për të mundësuar përdorimin nga ana e studentëve, biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë [Evidencë 88].
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Studentët e këtij programi studimi, si dhe personeli akademik, kanë mundësinë të shfrytëzojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit [Evidencë 89, Evidencë 90].
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” nuk ka të parashikuara orë laboratorit në planin e tij mësimor [Evidencë 56]. <i>GVJ është i mendimit që sigurimi i bazës së nevojshme laboratorike dhe zhvillimi i seancave përkatëse do të kontribonte fuqishëm në formimin në drejtimin përkatës të</i>

	<i>formimit.</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Megjithëse nuk mund të flitet për platforma të mirëfillta on-line (elearning), personeli akademik vë në dispozicion të studentëve variantin elektronik të leksioneve e prezantimeve të tyre (në adresën e përbashkët elektronike të krijuara nga grupi mësimor përkatës i studentëve të këtij programi studimi) si dhe inkurajon përdorimin e artikujve apo materialeve të tjera shkencore duke i adresuar në Rrjetin e sistemeve bibliotekare - informuese dhe sistemeve të informacionit për veprimtari shkencore <a href="https://www.cobiss.net/al/">https://www.cobiss.net/al/</a> [Vizita në bibliotekë, Takim me personelin akademik e studentët].								
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik (leksionet, prezantimet) dhe kanë hapësirë vetjake të dedikuar [Evidencë 91]. Gjithashtu ata shfrytëzojnë edhe komunikimin nëpërmjet postës elektronike për të shkëmbyer informacione lidhur me procesin mësimor në lëndët respektive [Takimi me studentët].								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare, pavarësisht faktit se në rregulloren përkatëse është parashikuar edhe përgatitja e temës së diplomës, për vitin akademik 2018-2019 dhe për atë aktual, studentët janë orientuar për diplomimin nëpërmjet provimit të përgjithshëm të formimit [RVB, Takime në institucion]. <i>GVJ është i mendimit që zhvillimi i temave të diplomave përbën një element të rëndësishëm të formimit profesional.</i> Nga ana e DSID u theksua fakti se diplomimi nëpërmjet provimit të përgjithshëm të formimit është një proces i përkohshëm dhe se prej tyre synohet që sa më shpejt që të jetë e mundur të propozohet edhe diplomimi nëpërmjet përgatitjes së temave të diplomave [Takime në institucion].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në UAMD funksionon Drejtoria e Kurikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Degës Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë [Evidencë 41]. Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies [Takime në institucion].

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>DSID është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” që ofron [RVB, Takime në institucion]. Në mënyrë të veçantë Përgjegjësi i DSID në bashkëpunim me përgjegjës in e grupit mësimor përkatës mbikqyr respektimin e planeve mësimore si dhe drejton punën për diskutimin dhe përmirësimin e planeve mësimore të programeve të studimit që ofron departamenti [Evidencë 24].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>DSID monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik [Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i DSID kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Nga ana e Departamentit dhe e FSP ka një mbështetje të vazhdueshme në drejtim të kualifikimit duke u krijuar mundësi si në drejtim të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore ashtu dhe në mobilitete në kuadër të projekteve europiane [Takime me personelin akademik].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>FSP në bashkëpunim me DSID ka si objektiv trajnimin e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Këtij objektiv i kanë shërbyer dhe i shërbejnë shkëmbimet me institucione të arsimit të lartë apo specialistë të huaj të fushës së detarisë [Evidencë 80].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se DSID është i përkushtuar në përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja [Takime në institucion]. Në mënyrë të veçantë synohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të afrohen programet me ato të universiteteve të tjera homologe;</li> <li>- të mundësohet që një modul të zhvillohet në gjuhë të huaj;</li> <li>- të synohet në rritjen e kapaciteteve të stafit me qëllim zhvillimin e mësimin edhe në gjuhë të huaj.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga ana e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është vënë theksi në zhvillimin e kapaciteteve të punës në grup dhe të një lidhjeje të ngushtë me praktikën [Takim me personelin akademik]. Eksperiencia e deritanishme në këtë drejtim ka rezultuar pozitive, ndërkohë që synohet edhe përmirësimi i bazës laboratorike në shërbim të mësimdhënies e mësimnxënies. Aktiviteti mësimor merret në analizë në mënyrë periodike duke adresuar problematikën e konstatuar [Evidencë 78].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor DSID ka angazhuar lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Për vitin akademik 2018-2019 janë organizuar tre leksione të hapur nga lektorë nga institucione të huaja</p>



ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	me të cilët UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi [Evidencë 95].		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

<b>Standardi III.5</b>			
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare” si dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse [Evidencë 25, Evidencë 56].		
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstatoi se studentët njihen me këta elementë që lidhen me programin e studimit që në kontaktin e parë me pedagogët, të cilët u prezantojnë syllabusin dhe mënyrën e vlerësimit [Takim me studentët].		
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara [RVB]. Përgjithësisht mënyra e vlerësimit është me dy provime, provimi i parë (ka 400 pikë të mundshme) e provimi përfundimtar (ka 500 pikë) dhe detyrat e kursit (të cilat kanë 100 pikë të mundshme) [Evidencë 56].	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara [RVB]. Përgjithësisht mënyra e vlerësimit është me dy provime, provimi i parë (ka 400 pikë të mundshme) e provimi përfundimtar (ka 500 pikë) dhe detyrat e kursit (të cilat kanë 100 pikë të mundshme) [Evidencë 56].		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X



<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Referuar syllabuseve të lëndëve, vlerësimi përfundimtar pasqyron rezultatet e një kontrolli të ndërmjetëm (40%) që zhvillohet në javën e 7-të apo të 8-të, vlerësimin e kontrollit përfundimtar (50%) si dhe vlerësimin për detyra e kursit (në masën 10%) [Evidencë 56]. Përsa i përket praktikës profesionale, ajo vlerësohet mbi bazën e një relacioni që përgatitet nga studentët, ndërsa zhvillimi i saj rregullohet bazuar në udhëzimin për praktikën profesionale të programit të studimit Master Profesional në “Logjistikë Dhe Siguri Detare” [Evidencë 45]. Në këtë udhëzim përcaktohet se studenti e prezanton përpara komisionit të vlerësimit punimin (relacionin) me tematikë të përcaktuar nga personeli akademik që ndjek Praktikën Profesionale. Në këtë referim ftohen edhe subjekte private që janë të

	fushës që mbulon programi i studimit përkatës. Vlerësimi bëhet me notë dhe pasqyrohet në proces-verbalin përkatës.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar <u>RVB</u> dhe takimeve me NjsBC [ <u>Takime në institucion</u> ], UAMD vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. UAMD që nga viti 2018 është pjesë e projektit CleanScore 2016-2018 të Albanian American Development Foundation.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Marrja e studentëve në provim kryhet nga komisioni i provimit i cili ngrihet nga përgjegjësi i Departamentit. Ky i fundit miraton edhe tezat e provimeve [ <u>Evidencë 25</u> ]. Referuar Rregullores së programit të studimit, në provim janë të pranishëm personeli akademik i lëndës (Profesori/lektori dhe asistent-lektori i lëndës), ose personeli akademik i lëndës dhe personeli akademik asistues i caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit (në rast se nuk ka asistent-lektor). Nëse asistuesi nuk paraqitet në provim, personeli akademik i lëndës njofton Përgjegjësin e Departamentit i cili merr masa për zëvendësimin e tij.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim. Për çdo seksion/grup mësimor personeli akademik duhet të përgatisë të paktën 4 teza të ndryshme provimi. Ato duhet të jenë të përgatitura sipas formatit të miratuar në DSID dhe nënshkruhen nga Përgjegjësi i Departamentit/Përgjegjësi i Grupit mësimor kërkimor-shkencor, jo më vonë se dita e fundit e javës që paraprin provimin [ <u>Evidencë 25</u> ]. Teza e provimit në funksion të specifikave të kursit përkatës mund të hartohet vetëm me pyetje me shtjellim; me pyetje me shtjellim dhe e kombinuar me alternativa ose ushtrime; por nuk lejohet vetëm me alternativa [ <u>Evidencë 97</u> ].
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura [ <u>Evidencë 25</u> ].
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nëse studenti kapet me kopje, i plotësohet nje formular, ku firmosin lektori i kursit dhe asistenti (lektori dhe asistent lektori i seminareve për lëndet që kanë asistent) dhe dorëzohet në Dekanat (Zv /Dekani mësimor). Ky student nuk e vazhdon më këtë kurs, por detyrohet t'a frekuentojë në vitin e ardhshëm akademik [ <u>Evidencë 97</u> ].
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të

	mësipërme [Evidencë 97].			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Korrigjimet e tezave kryhen gjithmonë me ngjyrë të dallueshme, e ndryshme nga ajo e tezës së studentit. Teza duhet të përmbajë domosdoshmërisht pikët sipas vlerësimit të grup-pyetjeve, si dhe pikët totale, të vendosura në pozicion të dukshëm brenda tezës. Nëse ka kontestime studenti ka të drejtë të shikojë korrigjimin e provimit të tij [Evidencë 97].			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa, i drejtohet me shkrim Drejtuesit të FSP jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i FSP ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. [RVB, Evidencë 25]. GVJ konstatoi se gjithë procedurat janë parashikuar qartë në Rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” [Evidencë 25] dhe “Udhëzuesin për procedurat e provimit të ndërmjetëm dhe të provimit përfundimtar” [Evidencë 97].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>


<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar Rregullores [Evidencë 25], programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” është program studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale një vit akademik, i cili merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në fushat e logjistikës detare dhe të sigurisë portuale e të mjeteve detare, si dhe në veprimtaritë e transportit detar si dhe ka për qëllim t'u ofrojë studentëve mundësinë që të thellojnë dhe zhvillojnë dijet si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e navigimit, të logjistikës dhe të sigurisë së mjeteve detare.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, <b>GVJ konstatoi një dimension ndërkombëtar të programit</b> [Takime me personelin akademik e studentë]. Vetë natyra e kompetencave të kërkuara garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit duke qenë se sektori detar është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj si dhe një komunikim intensiv duke

	shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Duke shfrytëzuar rezultatet e pyetsorëve të studentëve [Evidencë 74] dhe “Formularin e vlerësimit të performancës së personelit akademik” [Evidencë 92], DSID kryen analizën e problematikave të dala [Evidencë 78]. Gjithashtu nga takimi me personelin akademik të programit të studimit GVJ u njoh me synimet e shprehur prej tyre për përmirësimin e syllabuseve pas vitit të parë të zbatimit të programit të studimit për të integruar në to pasqyrimin e të rejave si dhe me nevojën e përdorimit të softuerëve në lëndë të ndryshme [Takime me personelin akademik].
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Pas kryerjes së kontrollot të ndërmjetëm, në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët duke nxjerrë në pah problematikën e hasur. Gjithashtu, personeli akademik është i gatshëm për të orientuar studentët për trajtimin e çështjeve të ndryshme dhe testin përfundimtar, duke ofruar konsultime sipas një grafiku të shpallur [Evidencë 79].
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Për vitin akademik 2018-2019 janë organizuar tre leksione të hapura nga lektorë nga institucione të huaja me të cilët UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi [Evidencë 95, Evidencë 75], të cilët i kanë shërbyer njohjes me zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi inkurajon zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve. Studentëve u kërkohet që njohuritë e përfuara në leksione e debatuar në seminare t’i konkretizojnë nëpërmjet detyrave të kursit si dhe praktikës profesionale [Takime me personelin akademik e studentë]. Në përfundim të praktikës profesionale studentëve u kërkohet të prezantojnë punimet e tyre [Evidencë 45]. Nga analiza e syllabuseve të lëndëve dhe takimet e zhvilluara në institucion, <i>GVJ rekomandon integrimin e seancave laboratorike në këtë program studimi.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi inkurajon punën në grup. Realizimi i detyrave të kursit përmbyllet me një referim përpara studentëve të kursit [Takime në institucion], duke u shoqëruar edhe me diskutime në grup me synimin përmirësimin e shprehive të komunikimit.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Zhvillimi i praktikave profesionale bazuar në marrëveshje të lidhura me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e detarisë [Evidenca 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52], kontribon për zhvillimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe krijon një bazë të mirë për studime të avancuara kërkimore e shkencore. GVJ, gjatë takimeve me personelin akademik e studentë konstatoi një lidhje të ngushtë të formimit universitar me praktikën e cila shërben si një laborator për zhvillimin e ideve dhe njohjen e avancimeve në këtë fushë [Takime me pedagogë e studentë].



<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Pavarësisht se në <u>RVB</u> thuhet se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato, GVJ është i mendimit se kjo mund të jetë e vlefshme për zhvillimin e aktivitetit kërkimor të personelit akademik. <i>Përsa u përket studentëve, pjesëmarrja në kërmimin shkencor mbetet embrionale.</i> Sipas GVJ kjo to të ishte e mundur në se diplomimi i studentëve të realizohej nëpërmjet një punimi diplome (të paktën për 30% të studentëve më të mirë të grupit). Në temat e diplomave do të mund të integroheshin elementë të kërkimit shkencor dhe të pasqyroheshin ide inovative.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ai brenda vendit kontribon për rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave. Deri më tani në rang ndërkombëtar bëhet fjalë vetëm për mobilitetin e stafit akademik [<u>Evidencë 80</u>], ndërsa nuk ka pasur mobilitete të studentëve të këtij programi studimi. Megjithatë GVJ është i mendimit se kryerja e praktikave profesionale në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit brenda vendit kontribon në mobilitetin e studentëve duke qenë se në mjaft raste ato janë realizuar në edhe në misione jashtë vendit [<u>Takime në institucion</u>].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.8</b></p>	
<p><b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>FSP ka vënë në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor Kabinetin e Navigacionit, i cili disponon gjithë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin cilësor të procesit të mësimdhënies [<u>Takime në institucion</u>]. Gjithashtu marrëveshjet me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e detarisë [<u>Evidenca 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52</u>], kontribuojnë për zhvillimin cilësor të praktikave profesionale. Përsa i përket infrastrukturës laboratorike në shërbim të këtij programi studimi, ajo nuk disponohet aktualisht, por mendohet të sigurohet në kuadër të kërkesës së përmirësimit të cilësisë së formimit të studentëve [<u>Takime me personelin akademik</u>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Zhvillimi i praktikave profesionale garantohej nga institucioni bazuar në marrëveshje të lidhura me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e detarisë [<u>Evidenca 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52</u>]. Kjo bën të mundur që studentët të azhurnohen me teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale [<u>Takime me pedagogë e studentë</u>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë</p>	<p>Praktika profesionale e programit të studimeve Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, ekuivalentohet në kredite (6</p>



studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	ECTS) dhe realizohet në përputhje me Udhëzimin për praktikën profesionale të programit të studimit Master Profesional në “Logjistikë Dhe Siguri Detare” [Evidencë 45]. Praktika profesionale mbyllet me një relacion praktike të dakortësuar më parë dhe vlerësohet nga një Komision i formuar nga personeli akademik që ndjek ecurinë e kësaj praktike dhe të paktën një personel akademik tjetër i brendshëm i grupit mësimor, kërkimor-shkencor “Menaxhimi i Transportit dhe Detarisë” i DSID. Vlerësimi bëhet me notë dhe pasqyrohet në proces-verbalin përkatës [Evidencë 101].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.9</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Rregullorja e programit të studimeve Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” parashikon procedurën për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës, dhe studentët janë të njohur me të [Takim me studentët]. Megjithatë, për vitin e parë akademik të zhvillimit të programit, diplomimi është realizuar me provim final [Takime në institucion].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen grupi mësimor, kërkimor-shkencor “Menaxhimi i Transportit dhe Detarisë”/DSID, ndërsa vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga DSID dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë të DSID [Evidencë 25, Takime në institucion].
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurisë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas RVB, komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, synon testimin e njohurive të dhëna gjatë vitit akademik, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Komisioni harton tezat e provimit duke pikëzuar pyetjet e lëndëve specifike sipas kategorizimit të veprimtarive (A-C), duke u dhënë më shumë rëndësi lëndëve kategorizuese të këtij program studimi [Takime në institucion].
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Për vitin akademik 2018-2019 diplomimi është realizuar vetëm me provim formimi. Megjithatë rregullorja e programit të studimit parashikon diplomimin me mbrojtje diplome [Evidencë 25]. Në rregullore janë parashikuar procedurat në lidhje me realizimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Personeli akademik synon që në vitet në vijim të realizohet diplomimi nëpërmjet mbrojtjes së temave të diplomës [Takime në institucion].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	

<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.									
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi bëhet me notë. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Studenti që kalon me sukses tezën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse [Evidencë 25].								
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin [Evidencë 28]. Në përfundim lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Logjistikë dhe Siguri Detare" në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Evidencë 1, Urdhër i MASR për hapjen e programit të studimit].								
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit "Logjistikë dhe Siguri Detare".								
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	FSP ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen [Vizitë në Sekretarinë Mësimore].								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të	UAMD përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Dega e burimeve njerëzore

<p>angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>është përgjegjëse për mbajtjen e këtij informacioni [Takim në degën e Burimeve Njerëzore]. Ky informacion është në dispozicion të njësive kryesore dhe atyre bazë të institucionit. Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale. Ky Departament drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe ka në përbërjen e tij, personel akademik me kohë të plotë (janë katërmbëdhjetë për vitin akademik 2018-2019), dhe me kohë jo të plotë 26 njëzet e gjashtë. Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor të këtij programi studimi për vitin akademik 2018-2019, përbëhet nga 9 (nëntë) mësimdhënës, nga të cilët 2 (dy) me titullin Prof. Dr., 1 (një) me titullin Profesor i Asociuar, 4 (katër) me gradën Doktor dhe 2 (dy) personel akademik me M.Sc.. Prej tyre 7 janë personel akademik efektiv dhe 2 personel akademik me kontratë [RVB, faqe 15].</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka hartuar dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. Rekrutimet bazohen në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e UAMD. Rekrutimi i personelit akademik i nënshtrohet praktikave të përcaktuara përkundrejt aplikimit me dosje dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit. Vlerësimi i tyre bëhet i njehsuar kundrejt kriterëve të përcaktuar [RVB, Takim në degën e Burimeve Njerëzore].</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UAMD ka hartuar procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i ka bërë ato publike. Kriteret përcaktohen nga DSID mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni Ad-Hoc i ngritur pranë departamentit [RVB, Takim në degën e Burimeve Njerëzore, Takim DSID].</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterëve të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Transparencës dhe garancisë për të përzgjedhur personelin me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit i shërben “Paketa e BNJ për rekrutimin e personelit akademik dhe praktika e ndjekur departament - dekanat -burime njerëzore- rektorat” [Evidencë 81]. Në mënyrë të veçantë dokumenti “Çelësi i vlerësimit të paketës së aplikimit për personel akademik”, paraqet qartë mënyrën e vlerësimit si për kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetet e vendit apo trojet ashtu edhe për kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetet e huaja, duke vendosur një sistem pikëzimi që merr në konsideratë gjithë elementët e kërkuar për angazhimin si mësimdhënës. GVJ është i mendimit se një proceurë e tillë transparente eviton subjektivizmat që mund të paraqiteshin gjatë rekrutimit të personelit</p>



	akademik.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Statuti, rregulloret) si dhe takimet me Dekanin e FSP, Përgjegjësen e DSID si dhe personelin akademik, GVJ konstaton se UAMD angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personelit akademik i janë krijuar mundësi të barabarta për zhvillimin e procesit mësimor, kualifikimin shkencor dhe përfshirjen në projekte kërkimore shkencore. Mjediset e punës, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, janë të aksesueshme nga personeli gjatë gjithë javës (përfshirë dhe fundjavën) për kryerjen e detyrave të tyre dhe zhvillimin cilësor të mësimdhënies [Takime në institucion].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga ana e DSID dhe e FSP ka një mbështetje të vazhdueshme në drejtim të kualifikimit duke u krijuar mundësi si në drejtim të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore ashtu dhe në mobilitete në kuadër të projekteve europiane për trajnime dhe mbajtje leksionesh [Takime me personelin akademik]. Nga analiza e DVV dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor të këtij programi studimi ka kualifikimin në fushën përkatëse (titulli, grada shkencore, studimet e kryera, etj). Gjithashtu, prioritet ka qenë mbështetja në drejtim të kualifikimit duke u mundësuar pjesëmarrjen në konferenca shkencore. Dëshmi për përpjekjet në drejtim të kualifikimit është aktiviteti botues i konsiderueshëm i personelit akademik [Evidencë 94].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	FSP në bashkëpunim me DSID ka si objektiv trajnimin e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Këtij objektiv i kanë shërbyer dhe i shërbejnë shkëmbimet me institucione të arsimit të lartë apo specialistë të huaj të fushës së detarisë [Evidencë 80].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga takimet në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik zotëron kualifikimin e duhur dhe është i angazhuar maksimalisht për realizimin e procesit mësimor [Takime në institucion]. Në programin e studimit për vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar 9 mësimdhënës, nga të cilët 2 (dy) me titullin Prof. Dr., 1 (një) me titullin Profesor i Asociuar, 4 (katër) me gradën Doktor dhe 2 (dy) personel akademik me M.Sc. Për vitin akademik 2019-2020 janë

	angazhuar 10 mësimdhënës. Gjithashtu ngarkesa e përballuar nuk është e lartë [Evidencë shtesë 2].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe vizitës në institucion [RVB, Evidencë 103: Planimetria e ambienteve], Fakulteti i Studimeve Profesionale ka në dispozicion për të garantuar zhvillimin e programeve të studimit që mbulon një sipërfaqe rreth 830m<sup>2</sup> (ku përfshihen Salla për leksione, klasa për seminare, salla për aktivitete promovuese, salla për praktikë lëndore/ profesionale, laboratorë për lëndët, laboratorë informatike , salla interneti , salla për bibliotekë , mjedis për fotokopjime, librari etj.). Veç këtyre disponon edhe mjedise për stafin (rreth 508m<sup>2</sup>) si dhe rreth 525m<sup>2</sup> mjedise të tjera për studentët (zyrë informacioni për studentët, mjedise sportive, mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore etj.).</p> <p>Veç kësaj, procesi mësimor për programin e studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” zhvillohet në fundjavë (e shtunë dhe e diel). Kjo bën të mundur që të kenë në dispozicion hapësira të mjaftueshme dhe cilësore dhe të respektohet kërkesa për hapësirën e nevojshme për student [RVB, Vizita në ambientet e zhvillimit të mësimi].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Zhvillimit të mësimi për këtë program studimi i është dedikuar Kabineti i Navigacionit i cili plotëson kushtet për zhvillimin cilësor të procesit mësimor (i pajisur me logjistikën e nevojshme projektor, stenda etj) [Vizita në ambientet e zhvillimit të mësimi].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Përsa i përket infrastrukturës laboratorike në shërbim të këtij programi studimi, ajo nuk disponohet aktualisht, por mendohet të sigurohet në kuadër të kërkesës së përmirësimit të cilësisë së formimit të studentëve [Takime me personelin akademik].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik të programit të studimit, GVJ u</p>

të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	njoy me synimet e shprehur prej tyre për të kompletuar një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me softuerë profesionale me qëllim përdorimin e tyre në lëndë të ndyshme [Takime me personelin akademik].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Zhvillimi i praktikave profesionale bazuar në marrëveshje të lidhura me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e detarisë [Evidenca 68]. <i>GVJ, gjatë takimeve me personelin akademik e studentë konstatoi një lidhje të ngushtë të formimit universitar me praktikën duke e konsideruar këtë si një nga pikat e forta të formimit në drejtim të Logjistikës dhe Sigurisë Detare</i> [Takime me pedagogë e studentë]. Mbetet që të merren masat e duhura organizative që zhvillimi i praktikës të mos çenojë zhvillimin normal të procesit mësimor në auditor.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>UAMD disponon një bibliotekë mësimore e cila është në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të veçantë dhe në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në Statutin e UAMD [Vizita në bibliotekë].</p> <p>Biblioteka përbëhet nga tre sektorë [Rregullorja e Bibliotekës, Vizita në bibliotekë]:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sektori i Informatikës dhe i Teknologjive të Reja në Shërbim të BUAMD</li> <li>2. Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve</li> <li>3. Sektori i Shërbimit dhe i Informacionit</li> </ol> <p>Ndër specifikat e bibliotekës mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Biblioteka është pjesë e projektit Cobiss, i cili përmban rreth 1700 rekorde të hedhura.</li> <li>- Biblioteka disponon sistemin e Arkives Dixhitale, duke mundësuar arkivimin dhe ruajtjen në format elektronik të fondit të Bibliotekës (me rreth 10 000 rekorde), si edhe servirjen e këtij fondi nëpërmjet portalit web. <a href="http://www.kataloguonline.uamd.edu.al">www.kataloguonline.uamd.edu.al</a>.</li> <li>- Biblioteka ka instaluar falas një sistem të integruar bibliotekar "KOHA".</li> <li>- Politika e pasurimit të BUAMD është drejtuar kryesisht për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.</li> <li>- Biblioteka qarkullon rreth 20.000 njësi bibliotekare në vit, dhe ka rreth 2000 përdorues në sallën e leximit me fonde të hapura</li> </ul>

	dhe te mbyllura.			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e UAMD është e pajisur me literaturë bazë si dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në gjuhën shqipe për mbulimin e lëndëve mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit “Logjistikë dhe Siguri Detare”. Biblioteka disponon hapsirat e mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët [Vizita në bibliotekë]. Në bibliotekën e UAMD janë të depozituara kopjet fizike të leksioneve të lëndëve të këtij programi studimi [Evidencë 86, Vizita në bibliotekë].			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Studentët e këtij programi studimi, kanë mundësinë të shfrytëzojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit [Evidencë 89, Evidencë 90].			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve [Vizita në bibliotekë].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Megjithë fondet relativisht të kufizuara, UAMD ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve të studimit. Janë të disponueshme gjithë leksionet në gjuhën shqipe në shërbim të programit të studimit, por literatura në gjuhë të huaj është akoma relativisht e kufizuar [Vizita në bibliotekë].			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Duke qenë se programi i studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare” zhvillohet në fundjavë, për të mundësuar përdorimin nga ana e studentëve, biblioteka qëndron e hapur edhe të shtunën e të dielën [Evidencë 88] dhe me kapacitetet që ka, mundëson përdorimin efektiv nga ana e studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAMD, që nga viti 2010 ka implementuar dhe ka në përdorim një sistem të integruar të menaxhimit të studentëve. Ky sistem i mundëson një menaxhim të integruar të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët. Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të institucionit. UAMD disponon bazën e të

	dhënave që përmban informacion mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e rregjistrimit në universitet, datë rregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritet mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe ja raportojnë organeve drejtuese kur nevojitet. [Evidencë 107, Vizitë në Sekretarinë Mësimore].
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UAMD administron informacionin e plotë të stafit akademik [Takime në institucion, RVB].
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UAMD disponon dokumentacionin e nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe për stafin administrativ. Dega e Burimeve Njerëzore disponon dosjet e të gjithë stafit akademik dhe administrativ që prej aplikimit të tyre. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje (p.sh një diplomë shtesë, një çertifikatë, publikim/botim në revistë shkencore etj). Informacioni mbi stafin e UAMD, disponohet edhe në formë elektronike ku çdo e dhënë hidhet në një bazë të dhënash mbi stafin [Evidencë 107, Vizitë në degën e Burimeve Njerëzore]. Gjatë vizitës në Degën e Burimeve Njerëzore u verifikuan dy dosje, respektivisht për PAE dhe për PAK, të cilat rezultuan me dokumentacionin e plotë.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit studentët dhe pedagogët përdorin edhe platforma të tjera komunikimi elektronik [Takim me studentët dhe stafin akademik].
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët [Takime në institucion, Vizitë në Sekretarinë Mësimore].
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	UAMD disponon një faqe Web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në Web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore

	Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në UAMD përgjatë gjithë vitit si dhe shërbimet e ofruara ndaj studentëve [Evidencë 107, <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/</a> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në Urdhërin e hapjes së Programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Logjistike dhe Siguri Detare", specifikohet se ai <i>financohet nga të ardhurat e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mënyrë të përhershme</i> [Evidencë 1]. GVJ nuk pati në dispozicion ndonjë raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Duke qenë se ky program studimi ndodhet në vitin e dytë të funksionimit të tij akoma nuk ka një analizë të plotë financiare për shpenzimet (janë evidentuar vetëm të ardhurat nga tarifat për dhe gjatë shkollimit) [Takime në institucion, RVB]. Softuerët e nevojshëm apo një simulator për të mundësuar zhvillimin e seancave laboratorike, mendohet të sigurohen në kuadër projektesh apo donacionesh [Takime në institucion].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	UAMD i nënshtrohet çdo vit një audit të brendshëm, të kryer njësia e Auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Në raportin vjetor paraqiten, zërat e shpenzimeve dhe të ardhurat e institucionit. Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Institucioni ndjek një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare. Referuar RVB, FSP, për programin e studimit "Logjistikë dhe Siguri Detare", harton projekt buxhet si për të gjithë programet e tjera dhe i përbledh ato në një të vetëm. Projekt buxhetet e secilit prej Fakulteteve përgatiten më pas në një të plotë dhe të përgjithshëm, në emër të të gjithë Universitetit, sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit. Buxheti i propozuar është objekt diskutimi në Senat dhe në Bordin e

	Administrimit të Institucionit. Në vijim të hartimit të buxhetit të Universitetit, ky i fundit diskutohet, plotësohet, miratohet në mbledhjet përkatëse të Senatit dhe Bordit të Administrimit [RVB, faqe 64, Takime me Dekanin e FSP dhe Përgjegjësen e DSID].								
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në RVB, faqe 66, thuhet se në mbyllje të vitit të parë të programit të cikilit të dytë Master Profesional në “Logistikë dhe Siguri Detare”, UAMD do të dokumentojë raportin financiar dhe FSP dhe DSID do të gjykojnë për ndërhyrje (nëse do të nevojiten), të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të këtij programi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Megjithatë edhe në Raportin e aktivitetit mësimit–kërkimor–shkencor të Departamenti të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë për vitin akademik 2018-2019 [Evidencë 78], GVJ nuk gjeti elementë të analizës financiare të programit të studimit “Logistikë dhe Siguri Detare”. Në DVV pasqyrohet vetëm planifikimi i të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Referuar “Raportit të veprimtarisë financiare për vitin akademik 2018-2019” dhe RVB, rezulton se UAMD garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi njëvjeçar studimi dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen [Evidencë 110], megjithatë, <i>GVJ është i mendimit se mungon një analizë e hollësishme financiare për programin e studimit “Logistikë dhe Siguri Detare”.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe	

të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.									
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve janë të shprehura qartë në rregulloren e Departamentit [Evidencë 24, Neni 44] dhe të programit të studimit [Evidencë 25, Neni 27] dhe publikohen në faqen elektronike të Fakultetit.  Studentët mund informohen për vijshmërinë e studimeve të tyre dhe rezultatet e provimeve përmes aksesimit të faqeve të tyre personale në Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentit AULA [Evidencë 91].								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë përcakton kuotat, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron, kjo në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë [Evidencë 24, Neni 44, pika 1].								
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit									
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kandidatëve, që në fazën e parë të aplikimit, u ofrohet paketa e programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, ku përfshihen: plani mësimor (kurrikula), stafi akademik, koha e realizimit, koha e përgatitjes dhe e mbrojtjes së diplomës (provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtjes së tezës) [Evidencë 25, Neni 28, pika 5].  Studentët e regjistruar pranë këtij programi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjësin (tutorin) e grupit të tyre mësimor mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik [Evidencë 25, Neni 13, Evidencë 25, Neni 95].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 25, Neni 33], duke ruajtur transparencën me kandidatin.



<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, si dhe format e ndryshme të vlerësimit të dijeve [Evidencë 56].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillim të vitit akademik, DSID informon studentët e regjistruar në programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe siguri detare” mbi procedurat e diplomimit. Bazuar në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 25, Neni 49]: “Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi.”  <i>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik dhe drejtues, dhe u konfirmua nga studentët që, gjatë vitit akademik 2018 - 2019, diplomimi i të gjithë studentëve ishte bërë me “provim formimi” dhe ishte parashikuar edhe për këtë vit akademik në të njëjtën mënyrë. Ky informacion ju ishte dhënë studentëve që në fillim të vitit.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të. Kryesisht studentët i përkasin programit të studimit <i>Bachelor</i> “Navigacion dhe Menaxhim Detar” i ofruar nga DSID (në vitin akademik 2018 – 2019, 21 studentë nga 29 - 72.4% i përkasin këtij profili).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht  <b>X</b>


<b>Standardi V.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Kandidatëve, që në fazën e parë të aplikimit, u ofrohet paketa e programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, ku përfshihen: plani mësimor (kurrikula), stafi akademik, koha e realizimit, koha e përgatitjes dhe e mbrojtjes së diplomës (provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtjes së tezës) [Evidencë 25, Neni 28, pika 5].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e regjistruar pranë këtij programi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjësin (tutorin) e grupit të tyre mësimor mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit [Evidencë 25, Neni 13, Evidencë 25, Neni 95].
Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me	

	përmbajtjen e syllabuseve [Evidencë 56]. Në kuadër të praktikës profesionale, DSID vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin e Praktikës Profesionale [Evidencë 45].			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe Departamentit informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktivitete këshilluese të organizuara në mënyrë periodike.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambientet e Universitetit dhe në faqen e saj <i>online</i> , të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve.  Nga të dhënat e sekretarisë mësimore [DVV dok. shtesë] GVJ konstaton si vijon më poshtë:			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.				
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që				
	<b>Viti akademik</b>	<b>Të regjistruar</b>	<b>Të ç'regjistruar</b>	<b>Të transferuar</b>
	2018 - 2019	29	0	0
	2019 - 2020	31	0	0

nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.				
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe ndjek punësimin e tyre përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Në brezin e parë të studentëve në programin <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, në vitin akademik 2018 – 2019 nga 29 studentë të regjistruar janë diplomuar 24 studentë (82.75%), 27 janë të punësuar (93.1%), 20 në fushën e studimit (68.97%).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët e UAMD kanë përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse [Evidencë 17, neni 90]. Institucioni mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Institucioni në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit kujdeset që të mundësojë transferimin e studimeve në hyrje dhe në dalje nga programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në kuadër të akreditimit të programit të studimit Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, Institucioni ka përfshirë në grupin e punës edhe përfaqësues të studentëve për të punuar dhe dhënë kontribut në hartimin e RVB [Evidencë 116].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studentin jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve [Evidencë 25, Neni 47]. Institucioni ndjek procedurat e parashikuara në rregullore për zgjidhjen e problematikës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b></p>	
<p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Pranë UAMD funksionon Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës [Evidencë 106]. Ky sektor është struktura përgjegjëse, që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit,</p>	

mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Master Profesional në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, në vitin akademik 2018 – 2019 nga 29 studentë të regjistruar janë diplomuar 24 studentë (82.75%), 27 janë të punësuar (93.1%), 20 në fushën e studimit (68.97%).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Jo përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Jo përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka ngritur Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (DKSC) [Evidencë Nr. 119], funksioni kryesor [Evidencë 17, Neni 81] i të cilës është bashkëpunimi dhe asistimi i Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë së brendshme dhe kurrikulave [Evidencë 17, Neni 79].  (DKSC) është e organizuar në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyrën e Sigurimit të Cilësisë;</li> <li>- Degën Mësimore;</li> <li>- NJBSC në nivel fakulteti [Evidencë 122].</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në planin e tij strategjik [Evidencë 22] për 5 vjeçarin 2016 – 2020, Institucioni ka prioritet të tij garantimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përmes kontakteve të vazhduara me përfaqësues të tregut të punës, pjesëmarrjeve në projekte, përgjegjësie dhe impakti social duke bashkërenduar të gjitha aktivitetet e tij në bashkëpunim të ngushtë midis aktorëve kryesorë: studentëve dhe stafit akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të	Institucioni i është nënshtruar me sukses akreditimit institucional [Evidencë 121]. Gjatë kësaj periudhe, Institucioni është kujdesur për futjen e programeve të studimit në fazën e vlerësimit dhe akreditimit nga ASCAL.

jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>DKSC në mënyrë periodike zhvillon dy pyetësorë me studentët:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre [Evidencë 120],</li> <li>2. Mbi cilësinë e infrastrukturës/shërbimeve të ofruara, dhe pëlqyeshmërinë e studentëve ndaj tyre,</li> </ol> <p>dhe pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrativ mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit [Evidencë 74].</p> <p>DKSC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Pranë FSP është ngritur NJBSC në nivel fakulteti [Evidencë 122], e cila kujdeset për zhvillimin korrekt dhe rishikimin në përputhje me standardet e cilësisë të programeve të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Institucioni në mënyrë periodike zhvillon dy pyetësorë me studentët:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre [Evidencë 120],</li> <li>2. Mbi cilësinë e infrastrukturës/shërbimeve të ofruara, dhe pëlqyeshmërinë e studentëve ndaj tyre,</li> </ol>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	dhe pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrative mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit [Evidencë 74].
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga DKSC. Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin 1, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,	Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e

rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	problematikave [Evidencë 76].			
	Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VL3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare” realizohet në mënyrë periodike përmes raporteve vjetore [Evidencë 78] nga koordinatorja e programit të studimit dhe përgjegjëse e DSID, në bashkëpunim me dekanin dhe NJSBC në nivel fakulteti.  Ky program studimi është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2018 – 2019, dhe është hera e parë që i nënshtrohet procedurave të vlerësimit dhe akreditimit.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Në rregulloren e SBC [Evidencë 119], Institucioni përcakton treguesit e matshëm të performancës. Në kuadër të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare” këto janë përshtatur me specifikat e tij.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni në mënyrë periodike zhvillon dy pyetësorë me studentët:  1. Mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre [Evidencë 120],  2. Mbi cilësinë e infrastrukturës/shërbimeve të ofruara, dhe pëlqyeshmërinë e studentëve ndaj tyre,  dhe pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrative mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit [Evidencë 74].  Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të	


tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare”, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Detyrat dhe përgjegjësitë e njëjësive dhe individëve përgjegjës për SBC të programeve të studimit janë të përcaktuara në Rregulloren e saj [Evidencë 119].
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Pranë FSP është ngritur NJBSC në nivel fakulteti [Evidencë 122], e cila nxit dhe mbështet punën në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të	



cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. GVJ gjatë vizitës, konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik, përgjegjësja e Departamentit dhe përfaqësuesit e NjSBC sollën eksperiencën e tyre lidhur me këtë proces.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave [Evidencë 76].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Analizat periodike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Logjistikë dhe Siguri Detare” gjatë takimeve me GVJ shprehën gadishmëri dhe vullnet të mirë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, nisur nga rekomandimet e lëna nga strukturat përkatëse brenda Institucionit, por edhe më gjerë nga rekomandimet e mundshme nga vlerësimi i jashtëm nga ASCAL.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	GVJ nga takimet me studentët dhe stafin akademik u informua se, Institucioni organizon mbledhje të hapura, në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë. Ata shprehën vullnet të mirë në



	drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Logjistikë dhe Siguri Detare” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit ofrohet në përputhje me nevojat specifike të territorit, duke ndërthurur njohuritë teorike në auditor me ato praktike, të mundësuara nga bashkëpunimet me institucione të konsoliduara vendase dhe të huaja në këtë fushë, duke krijuar një profil të specialistit, të aftë për t’iu përshtatur nevojave konkrete të tregut të punës në fushën e logjistikës dhe sigurisë detare.
2. Institucioni punon në mënyrë të vazhduar në kuadër të sigurimit të cilësisë, duke bashkërenduar punën e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në këtë proces.
3. Personeli akademik është i përkushtuar për zhvillimin me sukses të programit të studimit.
4. Dimension ndërkombëtar i programit të studimit.

**Pika të dobëta**

1. Ngarkesa e parashikuar për studentët është e pa ekuilibruar midis semestrit të parë dhe të dytë.
2. Orët e praktikave dhe orët e dedikuara diplomës nuk janë parashikuar si orë në auditor për studentin.
3. Ndarja e veprimtarive është vetëm në leksion/seminare dhe nuk konsiderohen edhe veprimtari si ushtrime/laboratore të përshtatshme me profilin inxhinierik të programit.
4. Detyrat e kursit/projektet nuk janë evidentuar në kurrikul (vetëm në syllabuset e lëndëve) si orë në auditor.
5. Praktikrat mësimore zhvillohen të shpërndara gjatë semestrit, duke krijuar përplasje me veprimtaritë e tjera mësimore.
6. Diploma, deri tani, është zhvilluar me “provim formimi”, pavarësisht se në rregulloren e programit parashikohet zhvillimi i saj edhe me “temë diplome”.
7. Mungesa e një laboratorit të teknologjisë së informacionit të pajisur me softuerë profesionalë në funksion të programit “Logjistikë dhe Siguri Detare”.
8. Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të Departamentit.



## **Rekomandime**

1. Një rishpërndarje më të ekuilibruar të krediteve midis semestrit të parë dhe të dytë.
2. Në kurrikulën e programit të konsiderohen orët e praktikave dhe orët e dedikuara diplomës si orë në auditor për studentin.
3. Ndarja e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/ seminare/ ushtrime/ laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”.
4. Evidentimi në kurrikul (jo vetëm në syllabuset e lëndëve) i krediteve të dedikuara detyrave të kursit/projekteve.
5. Përsa i përket praktikave mësimore, këto të organizohen të grumbulluara në fund të semestrit të dytë, në mënyrë që të mos ndërhyhet në zhvillimin korrekt të veprimtarive të tjera.
6. Të mundësohet diplomimi edhe me “Temë diplome”.
7. Kompletimi i një laboratorit të teknologjisë së informacionit të pajisur me softuerë profesionalë në funksion të programit “Logjistikë dhe Siguri Detare”.
8. Rritja e përfshirjes së studentëve në veprimtaritë kërkimore të Departamentit.

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master “Logistics and Maritime Safety” of Higher Education Institution “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

### **Strengths and affirmations**

1. The program of study is offered in accordance with the specific needs of the territory, combining theoretical knowledge in the auditorium with practice, enabled by collaborations with consolidated local and international institutions in this field, creating a specialized profile capable to fit to the specific needs of the labor market in the field of logistics and maritime security.
2. The institution works continuously in the framework of quality assurance, coordinating the work of all internal and external stakeholders in this process.
3. The academic staff is committed to the successful development of this program of study.
4. The international dimension of this program of study.

### **Weak points:**

1. The predicted workload for the students is unbalanced between the first and second semester.
2. The internship hours and the hours dedicated to the thesis preparation are not predicted as auditorium hours for the student.
3. The activities are divided only in lectures/seminars, and are not considered activities, such as exercises/laboratories in agreement with the engineering profile of the study program.



4. Course assignments/projects are not identified in the curricula (subject syllabus only), as hours in the auditorium.
5. Internship is organized during all the semester, creating clashes with other learning activities.
6. Diploma, so far, is organized as a "training exam", even though in the study program regulation it is also predicted by "diploma thesis".
7. Lack of an IT laboratory equipped with professional software in function of the study program in "Logistics and Maritime Security".
8. Limited students' involvement in the research activities of the Department.

### **Recommendations:**

1. A more balanced redistribution of credits between the first and second semester.
2. In the curricula of the study program, consider the internship hours and the hours dedicated to the thesis preparation as hours in the auditorium for the student.
3. Considering not only activities such as lectures/seminars, but also exercises/laboratories enabling students to develop practical classes even within specific subjects, and not only within the internship.
4. Course assignments/projects needs to be identified in the curricula (not just subject syllabuses).
5. Internships should be organized at the end of the second semester, so as not to interfere with other activities.
6. Enable graduation with a "Diploma Thesis".
7. Completion of an IT laboratory equipped with professional software in function of the study program "Logistics and Maritime Security".
8. Increase students' involvement in the research activities of the Department.

### **Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>			<b>X</b>	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA,</b>				<b>X</b>

<b>VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMITEVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Thoma Korini**



**PhD Genta Rexha**

